

Tiranë më 25 shkurt 2014

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë reagon ndaj shkurtimeve drastike të gazetarëve nga media publike, ATSH

Njoftohen per humbje te vendit te punes rreth 42 punonjes mes te cileve 26 gazetare e redaktore

Situatës së rënduar financiare dhe realitetit informal në marrëdhëniet e punës në mediat e vendit u shtohet edhe një valë e re shkurtimeve nga puna të gazetarëve. Gazetarë të Agjencisë Telegrafike Shqiptare kanë njoftuar pranë Unionit të Gazetarëve se gjatë dy ditëve të fundit kanë marrë shkresa zyrtare nga Drejtoria e institucionit përmes të cilave njoftohen për ristrukturim dhe njoftim për rishikim të kontratës së punës. Këtë shkresë tip e kanë marrë rreth 42 punonjës të këtij institucioni mediatik, ndërkohë prej të cilëve 17 gazetarë dhe 9 reporterë, mes të cilëve edhe reporteri që mbulon Kosovën.

Kjo është vala më e madhe e shkurtimeve që ndodh në njërin prej mediave publike të vendit ATSH, ndërsa situata e tillë pritet të përsëritet muajt e ardhëm edhe me mediat e tjera publike si RTVSH dhe filialet vendore në Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Kukës.

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë shpreh reagimin e vet ndaj kësaj mase drastike shkurtimeve si dhe nxjerrjen në mëshirë të fatit social të gazetarëve që për vite e dekada kanë punuar e janë investuar profesionalisht në profesionin e gazetarit, duke u gjendur befaz në një realitet të pambrojtur ekonomikisht.

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë konstaton se në vendimet e shkurtimeve drastike nuk ka respektim të meritokracisë dhe kriterëve profesionale, ndërkohë që ka keqinterpretime të neneve të Kodit të Punës.

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë nisur nga kjo situatë e re dhe realiteti i agravuar i pasigurisë sociale e ekonomike të gazetarëve në gjithë vendin, paralajmëron se në fundjavë do të ketë një konferencë shtypi dhe tubim para mediave publike në Tiranë, ku do të bëhen të njohura kërkesat dhe kushtet për negociim me vendimmarrësit dhe drejtuesit e institucioneve të mediave publike në vend.

Zyra e Shtypit
Unioni i Gazetarëve Shqiptarë